

Republika e Shqipërisë  
Dhoma e Noterisë Tiranë



Nr. 052 Rep.  
Nr. 300 Kol.



## KONTRATE DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

Sot me date 30/04/2019 (*dymije e nentembedhjetë*), para meje noteres Marsela V. Veseli, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, me zyre ne adresen Blv. "Gjergj Fishta", pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme per redaktimin e kesaj kontrate si me poshte vijon:

### Dhuruesi:

**Z. JOSIF VILA**, atesia Xhorxh, i datelindjes 10/02/1953, lindur ne Elbasan dhe banues ne Tirane i identifikuar prej meje nepermjet leternjoftimit Nr. 032204129, me numer personal **F30210185F**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e ortakut te Shoqerise "PERMETI MEAT CO", **Sh.p.k.**

### Pranuesi i dhurimit:

**Z. AGRON MERSINI**, i biri i Shabanit, i datelindjes 15.09.1968, lindur në Përmet, dhe banues në rrugen Myslym Shyri pallati 135 Tiranë, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin personal me nr. G80915111W.

Shoqeria "PERMETI MEAT CO" sh.p.k., eshte regjistruar si person juridik në datë 25/01/2018 me NIPT L88725201R, me keta ortakë: Andon (Andronaq) Cullufe me cilësinë e Ortakut, zoterues i 40% të kapitalit themeltar te shoqerise "PERMETI MEAT CO" sh.p.k., Josif Vila me cilësinë e Ortakut, zoterues i 5% të kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "PERMETI MEAT CO" sh.p.k. dhe Kristaq Traja me cilësinë e Ortakut zoterues i 55% të kapitalit themeltar te shoqerise "PERMETI MEAT CO" sh.p.k.

Shoqëria është rregjistruar pranë QKR-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njqind mije) leke.

Eshte marre vendimi i asamblese se pergjithshme te ortakeve nr. 2, date 25/04/2019 per tjetersimin e kuotave ne favor te Agron Mersini.

Në përputhje me "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", sipas Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare » i ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë hartohet kontrata e dhurimit si më poshtë vijon:

### Neni 1 Objekti

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, dhuruesi i kalon pranuesit te dhurimit pronesine mbi 5 (pese) % te kapitalit themeltar qe zoteron ne kete shoqeri si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht per titullin e pronësisë.

## Neni 2

### Kalimi i pronesisë

- Regjistrimi i kalimit të kapitalit do të kryhet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Transferimi i pronesisë mbi kapitalin e transferuar dhe regjistrimi i transferimit, behet menjehere me nënshkrimin e kesaj Kontrate. Pala përfituese merr përsipër të gjitha risqet që lidhen me kapitalin që përfiton pa ngritur në të ardhmen pretendime ndaj palës dhuruese.
- Pas regjistrimit të kesaj kontrate z. Agron Mersini behet ortak ne shoqerine "PERMETI MEAT CO" sh.p.k., zoterues i 5% te kapitalit te shoqerise

## Neni 3

### Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

## Neni 4

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

## Neni 5

### Të ndryshme

Kontrata iu lexohet palëve, të cilët e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në Ligjin Nr. 110/2018, datë 20/12/2018 "Për Noterinë".

Në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kesaj kontrate në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kontrata redaktohet në 4 ekzemplarë, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, nga të cilët një ekzemplar do të ruhet ne arkiven e noterit.


Unë noterja, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimeve, në bazë të ligjit.

### PALET KONTRAKTUESE

#### DHURUESI



#### PRANUESI I DHURIMIT



Notere  
Marsela Veseli



---

**REZULTATET E KËRKIMIT**

---

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-2019042610250264  
Data e Rezultatit të Kerkimit: 26.04.2019  
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 10:25:00AM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-561-519  
Referenca e Përdoruesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0**

PERMETI MEAT CO SH.P.K.

